


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.05.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-1293-14 për z.Eset Rama-Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, dhe Anëtar i Bordit të Ndërmarrjes Publike "Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK), për shkak se është shmangur situata që paraqet kufizim në ushtrimin e funksionit publik.

Ztr. Rama ka dhënë dorëheqje nga të qenurit Anëtar i Bordit të KMDK-së.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti është inicuar me kërkesen e vet zyrtarit të lartë ztr. Eset Rama i cili konform Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik (neni 8 paragrafi 5) i është drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit për Opinion ligjor lidhur me situatën e tij nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik (DPK/DPKI-03-1293/14).

Zyrtari i lartë, ztr. Rama, duke qenë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe në të njëjtën kohë Anëtar i Bordit të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK), situatën e tillë, Opinioni i Agjencisë e ka cilësuar si kufizim në ushtrimin e funksionit publik, duke iu referuar nenit 16 paragrafi 1 i cili shprehimisht thotë:

"Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit".

Pas pranimit të Opinioni të Agjencisë kundër Korrupsionit, zyrtari i lartë, ztr. Rama, për të shmangur situatën që ligji e quan "kufizimi i zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit publik", ka ofruar dorëheqje nga të qenurit Anëtar i Bordit të Ndërmarrjes Publike; Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK), (DPK/DPKI-03-1555/14).

Me këtë, zyrtari i lartë, ztr.Rama, ka parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, dhe tani ushtron vetëm pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

